



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



VENDIM

Nr. 1141, datë 24.12.2020

PËR

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE
TË PËRZGJEDHJES SË ORGANIZATAVE RINORE DHE/OSE
PËR TË RINJTË, QË PËRFITOJNË FINANCIME NGA FONDET
GRANT NGA BUXHETI I SHTETIT, TË DEDIKUARA PËR RININË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr.75/2019, "Për rininë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjencia Kombëtare e Rinisë (në vijim AKR), nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, finançon projektet e propozuara nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë apo njësítë e vetëqeverisjes vendore.
2. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:
 - a) "**Autoriteti financues**", Agjencia Kombëtare e Rinisë;
 - b) "**Kandidat**", çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, organizatë rinore apo organizatë për të rinjtë, përfitues të cilët marrin pjesë në një procedurë konkurrimi, sipas këtij vendimi dhe legjisacionit në fuqi;
 - c) "**Grant**", shuma e përcaktuar e fondit për mbështetjen e nismave dhe projekteve për të rinjtë, e shpallur në dokumentet e konkurrimit gjatë një procedure të parashikuar. Kjo shumë i jepet subjektit përfitues nga

AKR-ja, në përputhje me kriteret e vendosura sipas këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi;

- c) “**Dokumentet e konkurrimit**”, dokumentet që AKR-ja vë në dispozicion të të gjithë kandidatëve të interesuar për përgatitjen e projektpropozimeve.
3. Organizatat rimore, që do të përfitojnë mbështetje financiare, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr.75/2019, “Përininë”, si dhe kriteret e mëposhtme:
- Të kenë zbatuar, për një periudhë të paktën 2-vjeçare, projekte e programe me impakt tek të rinjtë;
 - Të mos janë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
 - Të mos kenë detyrime tatimore;
 - Të mos janë të dënuar organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë.
4. Organizatat për të rinjtë, që do të përfitojnë mbështetje financiare, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr.75/2019, “Përininë”, si dhe kriteret e mëposhtme:
- Të mos kenë detyrime tatimore;
 - Të mos janë të dënuar organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë.
5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, pas plotësimit të kritereve, si më poshtë vijon:
- Të paraqesin projektpropozimin për zhvillimin e projekteve rimore;
 - Të paraqesin shprehjen e interesit të miratuar nga kryetari i bashkisë.
6. Në procesin e shqyrtimit, të përzgjedhjes së subjekteve përfituese dhe të shpërndarjes së fondeve për mbështetjen e nismave dhe projekteve për të rinjtë, AKR-ja dhe Bordi Përzgjedhës i Projekteve mbështeten në parimet e mëposhtme:
- Lirisë në pjesëmarrje e konkurrimit;
 - Mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë;
 - Transparencës së procedurave e të vendimmarrjes, duke u ofruar të gjithë kandidatëve informacionin dhe procedurën përkatëse;
 - Përputhshmërisë me objektivat e grantit dhe me efektivitetin e përdorimit të burimeve, në bazë të sistemit të konkurrimit dhe të

kritereve, që mundësojnë vlerësimin e projektpropozimit dhe të specifikimeve teknike e financiare për përgjedhjen dhe shpërndarjen e grantit;

- d) Mungesës së prapaveprimit, duke përjashtuar mundësinë e shpërndarjes së fondeve për veprimtari tashmë të realizuara në datën e vendimmarrjes;
- dh) Paanshmërisë së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe parandalimit të konfliktit të interesave;
- e) Përjashtimit e mbivendosjes, që nënkupton shmangien e financimit të së njëjtës veprimtari për të njëtin interes konkret, më shumë se një herë, brenda të njëjtë vit financier.

II. PROCEDURA DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR MBËSHTETJEN E NISMAVE DHE TË PROJEKTEVE

7. AKR-ja harton dhe publikon, si më poshtë vijon:

- a) Programin vjetor të financimit.
 - b) Njoftimin paraprak e botimin e çdo procedure konkurrimi për një grant të caktuar dhe vënien në dispozicion të dokumenteve përkatëse të konkurrimit;
 - c) Ndryshimet dhe sqarimet e bëra gjatë procedurës.
 - ç) Dorëzimin e projektpropozimit dhe regjistrimin e kandidatëve pjesëmarrës nga AKR-ja.
 - d) Shqyrtimin e pranueshmërisë së plotësimit të aftësive teknike e financiare e të regjistrimit dhe vlerësimin e projektpropozimit.
 - dh) Njoftimin e rezultateve të konkurrimit, përfshirë kushtet për përshtatje ose ndryshime.
 - e) Në rast refuzimi të aplikimeve, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi.
 - ë) Negociimin e mundshëm për ndryshimet e përcaktuara, si kusht për miratimin e projektpropozimit fitues.
 - f) Negociimin dhe nënshkrimin e kontratës.
 - g) Botimin e informacionit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
8. AKR-ja, brenda muajit korrik të çdo viti, harton programin vjetor të financimit të projekteve rinore për vitin pasardhës dhe brenda muajit janar të çdo viti, skemën e shpërndarjes së pjesës së fondit grant, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore.
9. AKR-ja konsulton me Këshillin Kombëtar të Rinisë dhe grupet e interesit programin vjetor të financimit të projekteve rinore si dhe skemën e shpërndarjes së pjesës së fondit grant, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore.

10. Programi vjetor dhe skema e shpërndarjes i dërgohen për miratim ministrisë përgjegjëse për rininë.
11. AKR-ja shpall programin vjetor si dhe skemën e miratuar për shpërndarjen e pjesës së fondit grant, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore, në faqen e saj zyrtare në internet.
12. AKR-ja përgatit dokumentet e konkurrimit, në të cilat përfshihen:
 - a) Të dhëna të përgjithshme për AKR-në;
 - b) Kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm për të provuar këto kritere;
 - c) Kushtet e grantit;
 - ç) Udhëzime për afatet dhe formalitetet që duhet të respektohen;
 - d) Të dhëna për kriteret e përdorura për përzgjedhjen e kandidatëve;
 - dh) Njoftimi për thirrje për propozime, me afatet kohore të secilës fazë të thirrjes dhe fondi në dispozicion për çdo thirrje për projektpropozime;
 - e) Formulari i aplikimit;
 - ë) Formulari i zërave në terma financiarë;
 - f) Kontrata tip.
13. Aplikimi për mbështetje financiare, dërgimi i projektpropozimit dhe i dokumentacionit shoqërues nga organizatat rinore dhe/ose për të rintjtë si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore realizohet elektronikisht, përmes portalit përkatës të shërbimeve publike apo në faqen zyrtare të AKR-së.
14. Subjektet konkurruese duhet të plotësojnë dhe të ngarkojnë elektronikisht dokumentet e mëposhtme:
 - a) Formularin e aplikimit, ku të përcaktohet qartësisht qëllimi i projektit dhe veprimtaritë specifike që do të kryhen, në funksion të tij;
 - b) Aktin e regjistrimit në gjykatë;
 - c) Kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë zhvillimi i aktiviteteve rinore;
 - ç) Dokumentacionin që provon përvojë në zhvillimin e aktiviteteve rinore;
 - d) Vërtetimin nga organet tatimore që i ka përbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
 - dh)Vërtetimin nga gjykata të 3 (tre) muajve të fundit se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
 - e) Vërtetimin bankar të 3 (tre) muajve të fundit nga data e mbylljes së aplikimit;

- ë) Vërtetim nga gjykata të 3 (tre) muajve të fundit që nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor;
- f) Bilancin vjetor të tyre, si një kriter për të shpërndarë në mënyrë jo vetëm cilësore por dhe të drejtë grantin për financim;
- g) Projektpozimin përkatës dhe/ose dokumentet shoqëruese të tij.

15. Kushtet e grantit përbajnjë:

- a) karakteristikat e projektit;
- b) fushën e veprimit;
- c) objektivat specifikë;
- ç) veprimtaritë e nevojshme që duhen kryer;
- d) kriteret e vlerësimit të rezultateve.

16. Granti nuk do të përdoret në asnjë rast për financimin e kostove operative të tjera të kandidatit përfitues, jashtë projektit të përzgjedhur.

17. AKR-ja duhet të përcaktojë dhe të përfshijë në njoftimin për pjesëmarrje në një procedurë konkurrimi afatin e dorëzimit të projektpozimeve. Ky afat nuk mund të jetë më i vogël se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e botimit të njoftimit.

Afati për vlerësimin e projektpozimeve dhe shpalljen e rezultateve është jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga afati i përcaktuar në dokumentet e konkurrimit për dorëzimin e projektpozimeve.

Kandidatët njoftohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të vlerësimit të rezultateve të konkurrimit.

AKR-ja dhe kandidati përfitues nënshkruajnë kontratën brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të rezultateve të konkurrimit.

18. Subjektet konkuruese, projektpozimet e të cilave janë përjashtuar nga mundësia për financim, kanë të drejtë të paraqesin ankım në përputhje me legjislacionin në fuqi.

19. Vlerësimi i përbushjes së kritereve të projektpozimeve dhe subjekteve konkuruese kryhet nga AKR-ja, e cila ka për detyrë:

- a) të administrojë aplikimet nga organizatat rimore dhe/ose për të rinjtë, si dhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- b) të vlerësojë respektimin e parimeve dhe përbushjen e kritereve të subjekteve konkuruese dhe të projektpozimeve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

- c) të hartojë listën e projektpropozimeve, që plotësojnë kriteret, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga afati i fundit i dorëzimit të tyre;
 - ç) të monitorojë projektet fituese, brenda afateve të caktuara dhe në përmbushje të qëllimit e objektivave të paraqitura në projektpropozim.
20. Përzgjedhja e projektpropozimeve, që plotësojnë kriteret dhe janë pjesë e listës sipas shkronjës “c”, të pikës 19, të këtij vendimi, bëhet nga Bordi Përzgjedhës i Projekteve, i cili ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.
21. Bordi Përzgjedhës i Projekteve ka këto detyra:
- a) Hap, shqyrton dhe vlerëson kriteret e kualifikimit të projektpropozimeve të marra, në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara në dokumentet e konkurrimit;
 - b) Shpall rezultatet e konkurrimit dhe vë në dijeni kandidatët pjesëmarrës për projektet jofituese, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.
22. Vlerësimi mbështetet në përputhje me projektpropozimin e paraqitur nga kandidati aplikues në procedurat e konkurrimit për financime me grante me qëllimin e organizatës/aplikantëve dhe programin që zbaton, në kapacitetet e kandidatit/aplikantit, në efektshmërinë e aktiviteteve, në pritshmërinë dhe koston e tyre.
23. Projektet përbajnë të dhëna për qëllimin, objektivat specifikë, veprimtaritë, buxhetin, rezultatet e synuara. Vlerësimi i tyre parashtronet sipas treguesve të qartë e përcaktive të argumentuara. AKR-ja, për çdo thirrje për projektpropozime, vendos në dispozicion të aplikuesve template/shembull, i cili përmban strukturën dhe elementet bazë që duhet të ketë në përbajtje të tij projekti që do të propozohet.
24. Në kontratë përcaktohen mënyra e transferimit të fondit, dokumentacioni dhe mënyra e raportimit financier dhe performancës, llojet e shpenzimeve të njoitura e të pranueshme, format e kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve dhe e produktit/rezultateve të projektpropozimit të financuar, si dhe kushtet apo përgjegjësitë e tjera të ndërsjella.
25. Pagesat nga fondi buxhetor kryhen për organizatat rimore dhe/ose për të rinjtë me 3 këste:

- a) Kësti I, deri në 50% të vlerës së financimit menjëherë pas shpalljes fitues të projektit.
 - b) Kësti II deri në 40% të vlerës së projektit, menjëherë pas përfundimit dhe vlerësimit pozitiv mbi realizimin e fondeve të këstit I.
 - c) Kësti III 10% e vlerës së projektit, në përfundim të projektit, pas përfundimit dhe vlerësimit të suksesshëm të projektit.
26. AKR-ja shpall në faqen e saj zyrtare të internetit emrat e të gjithë përfituesve të projekteve, përbledhjen e projekteve të financaura dhe shumat përkatëse të granteve.
27. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

EVIS KUSHI

NR.PROT. 6547/1
DATË 12.1. 2021

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI



The circular stamp contains the text "REPUBLIKË SË KOSOVË" around the perimeter and "KËSHILLI I KOMBËTARË" in the center, with "DIPERISE" written vertically above "KËSHILLI".